

STATUT
“PIMAR ENGINEERING” SH.P.K

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

Sot, më datë 18.11.2021 Z. GIUSEPPE MARROCCO ,shtetas Italian me dt.02.10.1962 lindur Lecce dhe banues ne Lecce ,Itali posedues Ieternjofimit AS 7365687dhe Z.ANDI SELMANAJ shtetas shqiptar, me datëlindje 08.06.1982, lindur ne Vlore dhe banuese në Tiranë, adresa: Kombinat__Tirane, posedues i letërnjofimit shqiptar me Nr. I20608098L, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, r vendosen të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “PIMAR ENGINEERING” SH.P.K

Neni 2
Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) prodhimi, transformimi, transporti, tregëtimi, për llogari të saj dhe të të tretëve, i gurëve grez dhe/ose të përpunuar. Në mënyrë të veçantë: a) përpunimi i gurëve natrorë dhe të përbërë për përfitimin e produkteve për ndërtimin në përgjithësi, si edhe menaxhimi i kavave; b) përpunimi i gurëve për përfitimin e produkteve për përdorim artistik në përgjithësi, arredimi dhe dekorativë; c) tregëtimi, në fazat e ndryshme, i produkteve dhe mallrave për ndërtimin në përgjithësi, grez ose të përpunuara, si me shumicë, ashtu edhe me pakicë; 2) realizimin, mirëmbajtjen dhe restaurimin e ndërtesave civile dhe industriale, së bashku me punimet e lidhura dhe plotësuese; 3) realizimin, mirëmbajtjen dhe/ose menaxhimin e: veprave të urbanizimit kryesor dhe shërbimeve të lidhura me to; 4) tregëtimin e pasurive të paluajtshme, në pronësi të saj dhe të të tretëve, që bëjnë pjesë në programet organikë të ndërtimit për qëllim banimi. 3.3Për kryerjen e objektit të saj, Shoqëria do të mundë të përmbushë në përgjithësi çdo veprim tregëtar, financiar, në fushën e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si agjensi dhe subjekt përfaqësimi si edhe të ketë pjesëmarrje në Shoqëri dhe sipërmarrje të tjera, konsorciume, shoqëri konsortile dhe 2 bashkime të përkohshme operatorësh ekonomikë, aktiviteti i të cilëve është i lidhur ose shërben si ndihmë për aktivitetin e saj, të marrë kredi dhe financime në përgjithësi, të japë garanci edhe reale, gjithshka në format dhe me kushtet që organi administrativ do të konsiderojë më të duhurat. 3.4Shoqëria do të mundë të kryejë aktivitetet tregëtar, edhe importi e eksporti, si për llogari të saj, ashtu edhe për llogari të të tretëve, të pajisjeve, makinerive, impianteve, mobiljeve dhe materialeve të ndryshme të çfarëdolloji për tu përdorur në sektorin e pasurive të paluajtshme, atë industrial dhe në shërbimet, produkteve agrourbimore dhe vreshtave në përputhje me rregulloret në fuqi në secilin shtet të cilit i referohet; 3.5Shoqëria do të mundë të kryejë aktivitetet ndërtimi, blerje, shitje, shkëmbim ndërtesash civile dhe industriale, menaxhim pasurish të paluajtshme dhe kompleksesh turistikë dhe hotelerie si edhe aktivitetet zhvillimi bujqësor dhe pyllor, nëpërmjet blerjes, shitjes, shkëmbimit dhe administrimit të sipërmarrjeve bujqësore dhe real estate të çfarëdolloji; 3.6. Shoqëria do të mundë të kontraktojë punë publike me administratat shtetërore dhe lokale, duke marrë pjesë në tenderat përkatës të shpallur nëpërmjet ankandëve publikë, kërkesave për ofertë dhe kërkesave për negociim, në përputhje me legjislacionin n
- b) Çdo aktivitet tjetër të njohur me ligj.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4
Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne Tirane, Vore MARIKAJ Autostrada Durres-Tirane, Km.17, Zona Kadastrale nr.2596

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë ka një vlerë prej ALL 100.000 (njëqind mijë lekë) e përbërë nga 2 (dy) kuota, me vlerë nominale ALL 100.000 (njëqind mijë lekë) e zotëruar nga ortaku Giuseppe Marrocco 90% te aksioneve dhe ortaku Andi Selmanaj 10% te aksioneve.
2. Kontributi i ortakeve është në para dhe vlera integrale e kapitalit themeltar është nënshkruar dhe e pashlyer.

**Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
3. Në të gjitha rastet zvogëlimi e prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7
Transferimi i kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve (nëse do të ketë të tjerë), për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.


**KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8



Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike



- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
 5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
 6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblyemeve

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- g) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Përfshirimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
Administratori i parë i. do të jetë **“Carlo Giovanniello**
3. shtetas italian, me datëlindje 27.06.1957 lindur në Gravina in Puglia Itali dhe banues në shqipëri adresa: _Irfan Tomini ,hyrja 2,Ap 13,Kati 4,Tirane posedues i letërnjoftimit Italian me Nr.YA 9246305

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- b) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësia e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
2. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
3. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
4. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare », kryen veprimet e mëposhtme:
6. Administratori mund të kryejë teheqje në banke deri në vlerën 5000 euro në javë.

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivitetet shoqërisë;

- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.
- 7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.
- 8. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

- 1. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

- 1. Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :
 - a) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- 2. Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.
- 3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

4. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21


Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKET THEMELUES I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Emër, Mbiemër, Firmë)

GIUSEPPE MARROCCO



(Emër, Mbiemër, Firmë)

ANDI SELMANAJ

